



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

V E N D I M

Nr. 146, Datë 17 / 10 / 2019

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën me nr.81 Regj., datë 11.07.2019, të subjektit ankues O. K, kundër Drejtorit të Spitalit Universitar të Traumës (SUT), me pretendim diskriminimin për shkak të “*gjendjes arsimore*”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, O. K është në marrëdhënie pune me Spitalin Universitar të Traumës (SUT) prej 8 vitesh. Ai ka pretenduar se, që nga data 14.05.2018 është diskriminuar vazhdimisht nga ana e Drejtorit të SUT, përmes ndryshimit të vazhdueshëm, pa dëshirën e tij, të pozicioneve të punës, në kundërshtim dhe me formimin e tij profesional; si dhe përmes moslejimit për pjesëmarrje në trajnimet për ngritje profesionale.

Referuar kronologjisë së ngjarjeve të paraqitura në ankesë, konstatohet se:

Ankuesi, nëpërmjet shkresës me nr.2142/1 prot., datë 02.05.2018 “Miratim transferimi” është transferuar nga Kryeinfermier në Njësinë e Psikiatrisë së Fëmijëve, pranë Shërbimit të Psikiatrisë/Poli i Administrimit të Integruar të Spitalit të Neuroshkencës QSUT, në Kryeinfermier pranë Shërbimit të Kirurgjisë, Nr.2 në SUT.

¹Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

Me Vendimin nr.474 prot., datë 14.05.2018 është emëruar në detyrën e Kryeinfermierit në SUT dhe në zbatim të këtij vendimi, O. K ka nënshkruar Kontratën Individuale të Punës mes tij dhe SUT.

Subjekti ankues ka pretenduar se, megjithëse emërimi është firmosur nga Drejtori i SUT, që në momentin e transferimit të tij në këtë detyrë në Shërbimin e Kirurgjisë Nr.2, pranë SUT, ai nuk është mirëpritur dhe është ndjerë i sulmuar. Kështu ai ka renditur disa veprime të ndërmarra në dëm të tij dhe konkretisht:

- Nëpërmjet Urdhërit nr.1535 prot., datë 16.08.2018² “Dhënie mase disiplinore personel punonjës SUT”, ankuesit i është dhënë masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra”, pa dhënë asnjë arsye apo motivacion.
- Nëpërmjet Urdhërit nr.2736 prot., datë 11.12.2018³ “Dhënie mase disiplinore personel punonjës SUT”, ankuesit i është dhënë masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra”, duke cituar se:

“Për thyerje të pikës nr.4 të Deklaratës së Konfidencialitetit, si dhe për humbjen e kartelës mjekësore të pacientes L.N ish-paciente në Shërbimin e Kirurgjisë Nr.2/SUT, në muajin Qershor 2018”, z.K i jepet masa disiplinore “Zbritje nga detyra e K/Infermierit të këtij Shërbimi deri në një urdhër të dytë”.

Duke mos qenë dakord me masën disiplinore, subjekti ankues e ka kundërshtuar atë shkresërisht. Nëpërmjet shkresës me nr.19 prot., datë 04.01.2019 “Urdhër për heqjen e masës disiplinore dhe rikthim në detyrën personel punonjës K/Infermier në SUT”, ankuesi me datë 07.01.2019 është rikthyer në detyrën e K/Infermierit pranë këtij Shërbimi. Ankuesi ka pretenduar se mbas momentit të rikthimit të tij në këtë detyrë, vetë Drejtori i SUT e ka kërcënuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë verbalisht se do të bënte çmos deri sa ta largonte nga puna.

- Me anë të Urdhërit me nr.930 prot., datë 02.04.2019 ankuesi është liruar nga detyra e K/Infermierit dhe është emëruar në detyrë personel Infermier në SUT.

Ankuesi është shprehur se urdhëri sipërcituar ka ardhur si rezultat i zbatimit të shkresës me nr.145 prot., datë 26.02.2019 “Propozim për masë administrative “, për të cilën ai shprehet se nuk ka marrë asnjëherë dijeni dhe sapo është vënë në dijeni të këtij fakti ka kërkuar informacion, dokumentacionin përkatës, duke e kundërshtuar këtë masë të dhënë ndaj tij.

Z.K shprehet se kalimi i tij si Infermier Operator në Sektorin e Menaxhimit të Teknologjisë në SUT nuk është pranuar nga ana e tij në asnjë moment dhe se atij në këtë Sektor nuk i është caktuar asnjë vend se ku duhet të rrijë; dhomë, zyrë, sallë etj. Emërimin e tij si Infermier në këtë Sektor, i cili nuk ka pasur asnjëherë si pjesë të tij një “Infermier Sektori Menaxhimi të Teknologjisë”, në ndryshim të kushteve të Kontratës Individuale të Punës dhe për më tepër jo në përputhje me kualifikimin dhe arsimimin e tij, ankuesi e sheh si një mënyrë për ta poshtëruar dhe diskriminuar atë, sipas udhëzimeve të titullarit të SUT.

² Referuar deklarimeve të ankuesit, data që në shkresë është shënuar me 16.08.2017 është një lapsus material pasi duhet të ishte 16.08.2018.

³ Referuar deklarimeve të ankuesit, data që në shkresë është shënuar me 17.12.2017 sërish është një lapsus material pasi duhet të ishte 17.12.2018.

Këtë pretendim ankuesi shprehet se e provon përmes dokumentimit me anë të një audioje të bisedës të datës 27.05.2019⁴ nëpërmejet tij dhe shefit të Shërbimit të Kirurgjisë Nr.2, Dr.S.B, ku konstatohet se ai ka pohuar se nuk ka dashur ta shkruajë atë shkresë, por ka qenë i detyruar pas kërkesës së Drejtorit të SUT.

Në përfundim, subjekti ankues kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatimin e diskriminimit të tij nga ana e punëdhënësit dhe rikthimin në detyrën e mëparëshme, atë të K/Infermierit në Shërbimin e Kirurgjisë Nr.2/SUT.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së⁵, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

⁴ Subjekti ankues ka depozituar në cilësi prove, një CD me bisedën e regjistruar mes tij dhe Dr. S.B.

⁵Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

1. Me shkresën me nr.1098/1 prot., datë 22.07.2019 nga ana e KMD i është kërkuar informacion dhe dokumentacion provues SUT-së, lidhur me pretendimin e ankuesit.
- Me shkresën me nr.2006/1 prot, datë 29.07.2019, SUT ka dërguar një pjesë të dokumentacionit të kërkuar dhe ka parashtruar si më poshtë citohet:

“Z.O. K, ka ardhur me transferim nga QSUT “Nënë Tereza” në SUT, Me Urdhër të Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me nr.2142/1 prot., datë 02.05.2018. Me Urdhër të Drejtorisë së SUT, me nr.474 prot., datë 14.05.2018 është emëruar në detyrën personel K/Infermieror në SUT”.

Ndërkaq, në shkresë pasqyrohet fakti se, nëpërmjet Urdhrit nr.1535 prot., datë 16.08.2018, z.K i është dhënë masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra”, me motivacionin se ka thyer shumë rëndë disiplinën në punë, duke nxjerrë autoambulancën e SUT për kryerje shërbimi në rajonin e Tiranës, veprim i cili nuk është në kompetencë të tij. Me Urdhrit nr.2736 prot., datë 17.12.2018 sërisht i është dhënë masa disiplinore “Zbritje nga detyra e K/Infermierit të Shërbimit të Kirurgjisë nr.2, në SUT, deri në një urdhër të dytë”, masë e cila i është dhënë pas ankesës së një qytetari në portalin Zyra e Bashkëqeverisjes, lidhur me humbjen e kartelës mjekësore të mbesës së tij. Në vijm të shqyrtimit të kësaj mase disiplinore, në përfundim të saj, nëpërmjet Urdhrit nr.19, datë 04.01.2019 “Urdhër për heqje mase disiplinore dhe rikthim në detyrë personel punonjës K/Infermier në SUT”, z.O. K është rikthyer në detyrën që mbante përpara marrjes së masës disiplinore.

Në vijm, SUT informon se, me datën 25.02.2019 ka patur një ankesë tjetër, të një familjari të një pacienti të shtruar në Shërbimin e Kirurgjisë nr.2, në SUT, për O. K, i cili ishte K/Infermier pranë këtij Shërbimi. Familjari i pacientit akuzonte z.K se i kishte kërkuar lekë për medikamentet që duhet të jepeshin nga spitali. Lidhur me këtë ngjarje nga ana e Drejtorisë së SUT, është ngritur një grup pune, i përbërë nga K/Infermierja e Përgjithshme e SUT, Përgjegjësi i Sektorit dhe Specialisti i Burimeve Njerëzore të SUT. Po me këtë datë është mbajtur një takim me të dyja palët, ku edhe pse nga familjarët e pacientes u këmbëngul se medikamentet mjekësore të spitalit u janë dhënë me lekë, në përfundim të takimit ata u tërhoqën duke u shprehur se e falnin z.K lidhur me veprimin e tij.

Lidhur me sa mësipër, në vijim të propozimit me nr.145 prot., datë 26.02.2019 të Shefit të Shërbimit të Kirurgjisë nr.2 në SUT; me Vendimin nr.930, datë 02.04.2019 “Vendim për lirim nga detyra e K/Infermierit dhe emërim në detyrë personel Infermier në SUT”, z.K, është emëruar në detyrën Infermier/Operator në Sektorin e Menaxhimit të Teknologjisë në SUT, Sektor i cili ka në administrim dhe ndjekje të gjitha pajisjet mjekësore të SUT. SUT shprehet se: *“Në këtë Sektor punojnë edhe 3 infermiere të tjera, të cilat nuk janë ndjerë asnjëherë të diskriminuara.”*

SUT ka cituar gjithashtu, se, nëpërmjet shkresës së datës 08.09.2015 të Shërbimit të Ortopedisë të Pavionit nr.1, ku kishte qenë i punësuar më parë z.K evidentohen mangësi në punën e përditshme të tij.

Në përfundim të shkresës së saj, SUT, ka argumentuar se: *“Megjithë këto thyerje të rënda disiplinore, të kryera nga z.K, thyerje të Kodit të Etikës në raport me pacientin, prishje të gatishmërisë së automjeteve, moszbatim dhe mos realizim të detyrave të përditshme prej tij, nga ana jonë nuk është diskriminuar kurrë. Drejtoria e SUT, duke parë se është djalë i ri dhe familjar, është munduar t’i japë edhe një herë mundësinë për ta mbajtur në radhët tona, me synim përmirësimin dhe angazhimin e tij në punën e përditshme; pasi për thyerjet shumë të rënda të disiplinës në punë dhe të Kodit të Etikës në SUT, që ka bërë gjatë kësaj periudhë atij mund t’i ishte ndërprerë edhe Kontrata e Punës me SUT”.*

2. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr.10 221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës së z.O. K, Komisioneri me datë 08.10.2019⁶ planifikoi realizimin e seancës dëgjimore me palët në process.

Në seancë nuk u paraqit asnjëra nga palët, pasi paraprakisht:

- SUT, nëpërmjet shkresës me nr.2526/1 prot., datë 03.10.2019, informoi Komisionerin se, z.O. K, nga data 27.09.2019 e në vazhdim është emëruar me detyrë Kryeinfermier në Shërbimin e Ortopedisë Nr.1, në SUT.
- Subjekti ankues, nëpërmjet një bisede telefonike, konfirmoi se, me emërimin e tij në detyrë si Kryeinfermier në Shërbimin e Ortopedisë Nr.1, në SUT, ishte arritur qëllimi për të cilin ai kishte iniciuar ankesën pranë KMD-së. Këtë pohim, z.K e konfirmoi nëpërmjet e-mailit të dërguar KMD-së, bashkëlidhur të cilit dërgoi edhe një kopje të urdhrin të emërimit të tij.

Në kontekst të sa mësipër, Komisioneri vlerëson se, ndodhemi në kushtet kur kërkesa e subjektit ankues për t’u emëruar në detyrën Kryeinfermier në Shërbimin e Ortopedisë Nr.1, në SUT, është përmbushur gjatë procedurës hetimore të ndjekur nga KMD-ja, fakt ky i konfirmuar nga subjekti ankues dhe i dokumentuar nëpërmjet Vendimit nr.78, datë 27.09.2019 *“Për Emërim në Detyrë Personel Kryeinfermier në SUT⁷”*, të z. O. K.

Neni 33, pika 9 e LMD ka parashikuar se: *“Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër të cilit është paraqitur ankesa”.*

Komisioneri vlerëson frymën bashkëpunuese me SUT, lidhur me marrjen e masave për zgjidhjen me efektivitet të problematikës së subjektit ankues, z.O. K.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin dhe kishte iniciuar ankesa.

⁶ Referuar “Njoftimit për seancës dëgjimore” me nr.1098/3 prot., datë 20.09.2019.

⁷ Referuar shkresës me nr.2579 prot., datë 27.09.2019 të SUT-së.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 33, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe nenit 94, pika 1⁸ të Kodit të Procedurave Administrative Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative të nisur lidhur me shqyrtimin e ankesës të z.O. K, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin është iniciuar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Fusha: Punësim

Shkaku: Gjendja arsimore

⁸ “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”.

Adresa: Rruga e Durrësit, (Ish-Ministria e Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al